REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA GLLOGOC
GLLOGOC MUNICIPALITY
PRANUAR 14/01/2026
Nj. Org. | Numër | Shtojca | Vlera
01 | 060/04-43426

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit

PROCESVERBAL NGA TAKIMI I KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI (KKSB)

IZVEŠTAJ O SASTANKU OPŠTINSKOG ODBORA ZA BEZBEDNOST ZAJEDNICE (OOBZ)

Komuna / Opština: Drenas **Data / Datum:** 03.09.2026

Numri i takimit për këtë vit / Redni broj sastanka u ovoj godini: 4

Takim i rregullt / Redovni sastanak ☒ Takim i jashtëzakonshëm / Vanredni sastanak ☐

Numri i anëtarëve të KKSB-së të pranishëm / Broj prisutnih članova OOBZ: 10

A kanë marrë pjesë në takim përfaqësuesit e komuniteteve jo shumicë, nëse janë anëtarë të KKSB-së?
Da li su predstavnici nevećinskih zajednica, u svojstvu članova OOBZ, prisustvovali sastanku?

Po / Da ☐
Jo / Ne ☒
Nuk ka anëtarë që përfaqësojnë komunitetet jo shumicë/Nema članove koji predstavljaju nevećinske zajednice ☐

A kanë marrë pjesë anëtarë të tjerë përveç anëtarëve të KKSB-së?
Da li je neko osim članova OOBZ prisustvovao sastanku?

Po / Da ☒
Jo / Ne ☐
Nëse "Po", ju lutem potenconi organizatën të cilën e përfaqësojnë

Ukoliko je odgovor "Da", molimo navedite koje organizacije predstavljaju

Përfaqësues të KFOR—it dhe MPB-së, përkatësisht Zëvendësministri z.Enver Dugolli dhe z.Dardan Duraku nga MPB/DSB. Gjithsej me anëtarët e KKSB-së, 15.

A është kryesuar takimi nga Kryetari i Komunës apo nënkryetari?

Da li je sastankom predsedavao Gradonačelnik ili Zamenik?

Po / Da ☒

Jo / Ne ☐

Temat në rendin e ditës / Teme na dnevnom redu:

Rendi i ditës:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të KKSB-së të mbajtur me datë 16.06.2026.
2. Gjendja e sigurisë në Komunën e Drenasit, informim nga Stacioni Policor në Drenas;
3. Përgatitjet për vitin shkollor 2026/2027;
4. Njoftim lidhur me furnizim me ujë dhe çështjen e mbeturinave;
5. Të ndryshme

Ju lutem, potenconi temat tjera për të cilat është diskutuar në të ndryshmet / Molimo navedite druge teme o kojima se diskutovalo:

Me datë 03.09.2026 është mbajtur mbledhja e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB), të cilën e hapi dhe e udhëhoqi kryesuesi i KKSB-së, Arben Shala. Në mbledhje morën pjesë anëtarët e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, përfaqësues të institucioneve relevante dhe zëvendësministri i MPB-së, z.Enver Dugolli.

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të KKSB-së të mbajtur me datë 16.06.2026.

Në pikën e parë të rendit të ditës u shqyrtua procesverbali i mbledhjes së rregullt të KKSB-së, të mbajtur më 16 Qershor 2026. Lidhur me këtë pikë nuk pati vërejtje lidhur me përmbajtjen dhe u miratua unanimisht nga anëtarët e KKSB-së.

2. Gjendja e sigurisë në Komunën e Drenasit, informim nga Stacioni Policor në Drenas.

Fillimisht, për këtë pikë të rendit të ditës, fjalën e mori Zëvendësministri i MPB-së, z. Enver Dugolli. Ai theksoi se takimet e KKSB-së paraqesin një mundësi të rëndësishme për të dëgjuar nga afër shqetësimet e qytetarëve lidhur me sigurinë, për të vlerësuar punën e mekanizmave të sigurisë dhe për të

Ukoliko je odgovor "Da", molimo navedite koje organizacije predstavljaju

Përfaqësues të KFOR—it dhe MPB-së, përkatësisht Zëvendësministri z.Enver Dugolli dhe z.Dardan Duraku nga MPB/DSB

A është kryesuar takimi nga Kryetari i Komunës apo nënkryetari?

Da li je sastankom predsedavao Gradonačelnik ili Zamenik?

Po / Da ☒

Jo / Ne ☐

Temat në rendin e ditës / Teme na dnevnom redu:

Rendi i ditës:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të KKSB-së të mbajtur me datë 16.06.2026.
2. Gjendja e sigurisë në Komunën e Drenasit, informim nga Stacioni Policor në Drenas;
3. Përgatitjet për vitin shkollor 2026/2027;
4. Njoftim lidhur me furnizim me ujë dhe çështjen e mbeturinave;
5. Të ndryshme

Ju lutem, potenconi temat tjera për të cilat është diskutuar në të ndryshmet / Molimo navedite druge teme o kojima se diskutovalo:

Me datë 03.09.2026 është mbajtur mbledhja e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB), të cilën e hapi dhe e udhëhoqi kryesuesi i KKSB-së, Arben Shala. Në mbledhje morën pjesë anëtarët e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, përfaqësues të institucioneve relevante dhe zëvendësministri i MPB-së, z.Enver Dugolli.

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të KKSB-së të mbajtur me datë 16.06.2026.

Në pikën e parë të rendit të ditës u shqyrtua procesverbali i mbledhjes së rregullt të KKSB-së, të mbajtur më 16 Qershor 2026. Lidhur me këtë pikë nuk pati vërejtje lidhur me përmbajtjen dhe u miratua unanimisht nga anëtarët e KKSB-së.

2. Gjendja e sigurisë në Komunën e Drenasit, informim nga Stacioni Policor në Drenas.

Fillimisht, për këtë pikë të rendit të ditës, fjalën e mori Zëvendësministri i MPB-së, z. Enver Dugolli. Ai theksoi se takimet e KKSB-së paraqesin një mundësi të rëndësishme për të dëgjuar nga afër shqetësimet e qytetarëve lidhur me sigurinë, për të vlerësuar punën e mekanizmave të sigurisë dhe për të

diskutuar bashkërisht mënyrat e parandalimit dhe adresimit të sfidave që prekin komunitetin. Z. Dugolli theksoi se siguria është një nga prioritetet e Republikës së Kosovës dhe se institucionet kanë një angazhim të vazhdueshëm në këtë drejtim. Sipas tij, KKSB-të kanë rol të rëndësishëm, pasi në nivel lokal problemet e sigurisë mund të identifikohen më herët dhe përgjigjja institucionale mund të jetë më e shpejtë dhe më konkrete. Ai veçanërisht vuri theksin në sigurinë në shkolla dhe parandalimin e dukurive negative, duke përmendur edhe hartimin e Strategjisë Nacionale për Sigurinë në Bashkësi nga MPB-ja.

Kryesuesi i KKSB-së, z. Arben Shala, theksoi se KKSB-ja në Drenas është një mekanizëm serioz, i cili gjatë punës së tij ka adresuar një numër të konsiderueshëm të çështjeve të sigurisë. Ai theksoi se çështjet që kanë qenë në kompetencë të komunës janë adresuar dhe realizuar, ndërsa kërkoi përkushtim dhe bashkëpunim edhe nga institucionet qendrore.

Lidhur me gjendjen e sigurisë raportoi zëvendëskomandanti i Stacionit Policor në Drenas, z. Driton Morina. Ai theksoi se gjatë periudhës raportuese gjendja e sigurisë në territorin e Komunës së Drenasit, në përgjithësi, ka qenë e qetë dhe nuk janë evidentuar probleme të mëdha të sigurisë. Ndër çështjet operative të trajtuara gjatë kësaj periudhe ishin siguria në trafik dhe aktivitetet e shtuara gjatë sezonit veror. Sipas raportit të Policisë, gjatë periudhës raportuese janë shqiptuar 7,925 gjoba në trafik, janë evidentuar 145 aksidente, 1 rast dhunimi dhe 1 rast i sulmit seksual. Komandanti Morina theksoi se janë evidentuar raste të përdorimit të laserëve ndaj mjeteve ajrore civile, si dhe ndaj helikopterëve të KFOR-it. Sipas tij, disa nga lokacionet ku janë evidentuar këto raste ndodhen në zona malore, gjë që e ka vështirësuar identifikimin e personave përgjegjës. Ai bëri të ditur se për këtë çështje janë zhvilluar kontakte dhe është bashkëpunuar me KLSP-në në Komoran, ndërsa janë njoftuar edhe institucionet përkatëse.

3. Përgatitjet për vitin shkollor 2026/2027.

Drejtori i DKA, Muhamet Gjoka ka bërë të ditur se procesi mësimor ka filluar me kohë në të gjitha shkollat e Komunës së Drenasit, në përputhje me kalendarin e miratuar nga Ministria e Arsimit. Sipas tij, Komuna e Drenasit ka bërë përgatitjet e nevojshme për fillimin e vitit të ri shkollor, përfshirë rekrutimin e stafit, me qëllim që të mos ketë mungesa të personelit. Gjithashtu, ai njoftoi se furnizimi me tekste shkollore ka përfunduar. Sa i përket ditarëve shkollorë, ai theksoi se ekziston një vonesë në furnizim, pasi Ministria e Arsimit ka përzgjedhur një operator ekonomik dhe furnizimi i të gjitha librarive ende nuk ka përfunduar. U shpreh pritja që kjo çështje të përfundojë gjatë javës. Drejtori Gjoka theksoi se

është duke u hartuar një strategji lidhur me sigurinë në shkolla, ndërsa kontrollet në shkolla zhvillohen në mënyrë të vazhdueshme për parandalimin e përdorimit të duhanit dhe mjeteve të tjera të ndaluara me ligj.

Zëvendësministri Dugolli pyeti për zbatimin e planit të ligjëratave nëpër shkolla nga Policia e Kosovës dhe FSK-ja, duke theksuar rëndësinë e informimit dhe parandalimit të dukurive negative tek të rinjtë. Drejtori Gjoka njoftoi se ligjëratat janë të vazhdueshme dhe zhvillohen në bashkëpunim me Policinë dhe psikologët e shkollave. Ai gjithashtu bëri të ditur se shkollat kanë plane të emergjencës për raste të ndryshme, përfshirë evakuimin, zjarret dhe reagimet emergjente.

Në vijim u diskutua edhe për përfshirjen e komuniteteve fetare në aktivitetet informuese dhe parandaluese në shkolla. Kryesuesi Shala theksoi se Komuna bashkëpunon me Zyrën për Barazi Gjinore, DKA-në dhe Policinë e Kosovës në trajtimin e çështjeve si dhuna, zjarrvëniet dhe dukuritë e tjera negative. Ai theksoi se janë zhvilluar diskutime edhe me komunitetet fetare në komunë.

Z. Bajraktari, përfaqësues i komunitetit fetar, theksoi se është pjesëmarrës prej disa vitesh në punën e KKSB-së dhe se kanë bashkëpunim të mirë me Policinë, por nuk ka pasur pjesëmarrje konkrete të komunitetit fetar në ligjëratat e zhvilluara në shkolla.

Komandanti Morina theksoi se janë përgatitur plane operative për sigurinë në shkolla dhe se janë caktuar nga dy zyrtarë policor civil për shkollat e mesme. Ai njoftoi se gjatë vitit janë mbajtur 31 ligjërata me gjithsej 1,163 pjesëmarrës, në bashkëpunim me DKA-në, me fokus të veçantë tek nxënësit e shkollave të mesme.

4. Njoftim lidhur me furnizim me ujë dhe çështjen e mbeturinave

Në këtë pikë u diskutua për gjendjen e furnizimit me ujë të pijshëm dhe menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Drenasit. Kryesuesi i KKSB-së, z. Arben Shala, theksoi se gjatë tre muajve të fundit Komuna e Drenasit është përballur me vështirësi të mëdha në furnizimin me ujë. Ai theksoi se Komuna gjatë viteve të fundit ka investuar mbi 2 milionë euro në shtrirjen e rrjetit të ujësjellësit, ndërsa, sipas tij, këto investime ende nuk kanë rezultuar me furnizim të qëndrueshëm me ujë për qytetarët. Ai theksoi gjithashtu se një pjesë e pompave janë të amortizuara dhe se vetëm një pompë është funksionale, ndërsa dy të tjera nuk janë në funksion. Sipas tij, kompania e ujësjellësit ka qenë e informuar për gjendjen e këtyre

pajisjeve. Në lidhje me këtë çështje, ai kërkoi që problematika e furnizimit me ujë në Drenas të adresohet edhe në nivel qendror.

Lidhur me menaxhimin e mbeturinave, z. Nexhmedin Gruda theksoi se gjendja në Komunën e Drenasit është e vështirë. Ai theksoi se për më shumë se dy muaj Njësia Operative në Drenas ka operuar praktikisht vetëm me një kamion funksional, gjë që, sipas tij, ka ndikuar drejtpërdrejt në grumbullimin e mbeturinave. Sipas tij, në shumë fshatra dhe lagje mbeturinat nuk janë grumbulluar për periudha prej katër deri në pesë javë. Ai e cilësoi këtë si çështje që përveç aspektit të shërbimit komunal, paraqet edhe shqetësim për shëndetin publik. Ai ngriti shqetësimin edhe për gjendjen e Pikës së Transferit, e cila, sipas tij, është e stërmbushur me mbeturina dhe kërkon ndërhyrje. Gruda theksoi se Komuna e Drenasit ka vazhduar ta mbështesë KRM "Pastrimi", duke i dhënë në shfrytëzim katër kamionë, si dhe duke investuar çdo vit në blerjen e kontejnerëve të rinj. Sipas tij, nga katër kamionët e dhënë në shfrytëzim, tre janë jashtë funksionit, ndërsa gjendja e tyre është përkeqësuar për shkak të mungesës së mirëmbajtjes së rregullt. Ai theksoi se edhe marrëveshja e kompanisë me Komunën për mirëmbajtjen e hapësirave publike, pastrimin dhe larjen e rrugëve po realizohet vetëm pjesërisht. Në të njëjtën kohë drejtori vlerësoi punën e punëtorëve të Njësisë Operative, të cilët, pavarësisht kushteve të vështira të punës, gjatë vitit 2025 kanë grumbulluar mbi 8,200 tonë mbeturina. Ai prezantoi edhe të dhënat financiare sipas të cilave gjatë vitit 2025 janë arkëtuar 491,762.54 euro, që përfaqësojnë 80.88% të faturimit, ndërsa deri në muajin gusht 2026 janë arkëtuar 304,895.83 euro, ose 80.39% e faturimit. Në diskutim u theksua se qytetarët po tregojnë përgjegjësi në pagesën e shërbimeve dhe se kërkohet që kjo të shoqërohet me ofrimin e shërbimeve cilësore nga kompania. Po ashtu, u bë e ditur se Komuna ka zhvilluar komunikim të vazhdueshëm me Kryeshefin Ekzekutiv të kompanisë, përmes takimeve, kërkesave dhe raportimeve lidhur me problemet e evidentuara.Në fund të diskutimit u theksua nevoja që çështjet e ngritura të mos mbeten vetëm në nivel të evidentimit të problemeve, por të ndërmerren veprime konkrete nga institucionet përgjegjëse.

Zëvendësministri Enver Dugolli deklaroi se është i informuar për gjendjen e vështirë në Drenas sa u përket çështjeve të ujit dhe mbeturinave. Ai theksoi se nuk ka qenë në dijeni për nivelin e investimeve të Komunës në këto fusha dhe u shpreh se, nga pozita e tij, do t'i adresojë këto shqetësime tek institucionet përkatëse, secili në kuadër të përgjegjësive të veta.

5.Të ndryshme

Arben Haziri nga Këshilli Prindërve, dhe administrator fshatit Krajkovë, ngriti çështjen e urës në Shtrubullovë, duke theksuar se ura ka rreth nëntë muaj që po prësin për ndarjen e mjeteve dhe rregullimin e saj. Lidhur me këtë çështje, Nënkryetari Shala bëri të ditur se tashmë është nënshkruar memorandum ndërmjet kryetarit Lladrovci dhe Ministrit Basha. Kurse, Zëvendësministri Dugolli theksoi se do ta adresojë këtë çështje në mënyrë që të ndërmerren veprimet e nevojshme sa më shpejt.

Anëtari Skender Bogiqi nga KLSP ngriti dy çështje:
Hapje një pike të zjarrfikësve në Komoran, me qëllim të reagimit më të shpejtë në raste emergjente dhe regullimin e udhëkryqit/rrethrrotullimit të QMF në Komoran. Edhe për këto çështje, Zëvendësministri Dugolli u shpreh se do të interesohet për adresimin dhe shtyrjen përpara të këtyre projekteve.

Në fund, përfaqësuesi i FSK-së njoftoi anëtarët e KKSB-së se në territorin e komunës do të zhvillohen disa lëvizje të forcave Amerikane, Kroate, të Shqipërisë dhe FSK. Ai theksoi se bëhet fjalë për ushtrime dhe se institucionet lokale duhet të jenë të informuara me kohë.

Procesverbali u përpilua nga koordinatori i KKSB-së:
Izveštaj pripremio Koordinator OOBZ: Laureta Thaqi
(emri, mbiemri dhe nënshkrimi / ime, prezime i potpis)

Procesverbali aprovohet nga Kryetari: **Ramiz Lladrovci**

Izveštaj odobrava Gradonačelnik:

Nënshkrimi / potpis

Data e aprovimit / Datum odobravanja: 14.10.2026

Rekomandimet:

Dërgimi i këtij procesverbali është obligim që del nga UA 27/2012 MPB – 03/2012 MAPL neni 11 pika 6;
Procesverbali përpilohet nga koordinatori i KKSB-së në Komunën përkatëse;
Procesverbali duhet të dërgohet në MPB në e-mail adresën: mpb.dsb@rks-gov.net
Procesverbali duhet të dërgohet në MAPL në e-mail adresën: Shkrimorja.Mapl@rks-gov.net
Procesverbali duhet të dërgohet njëkohësisht me ftesën e takimit të ardhshëm të KKSB-së.